RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO

Nr. 0015/19

Data 23.01.2019
PRISHTINË

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive që rrjedhin nga dispozitat e Ligjit të Radiotelevizionit të Kosovës nr. 04/L-046, Statutit të RTK, Neni 19, pika7, dhe konkluzave të mbledhjes së Bordit të RTK-së të datës 22.01.2019 lidhur me caktimin e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm në Radiotelevizonin e Kosovës, Bordi i RTK-së merr:

VENDIM

Z. Mufail Limani, aktualisht Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i RTK-së, caktohet Ushtrues Detyre i Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, për një periudhë të caktuar kohore, duke filluar nga data 28.01.2019 deri në përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, por jo më shumë se gjashtë muaj;

ARSYETIMI

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Bordi i RTK më datë 19.11.2018 ka shpallur konkursin publik për plotësimin e pozitës së Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së. Konkursi është mbyllur më datë 03.12.2018. Komisioni përzgjedhës pas vlerësimit të aplikacioneve, më datë 11.12.2018 merr vendim për rishpallje të konkursit publik për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së në afat ligjor.

Meqenëse rishpallja e konkursit publik është në procedim e sipër, ndërsa mandati ligjor i Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së skadon më datë 27.01.2019, Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës ka vendosur që z. Limani të caktohet Ushtrues Detyre i Drejtorit deri në zgjedhjen e drejtori të ri, por jo më gjatë se gjashtë muaj nga data e caktimit.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

Antarëve të Bordit të RTK-së

Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së

Sekretarisë së Bordit

Arkivit

Afërdita Maliqi

Kryetare e Bordit Të RTK-së

A. Maliqi

RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS • RADIO TELEVIZIJA KOSOVA • RADIO TELEVISION OF KOSOVO